



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Tetor, 2024

01-31 Tetor, 2024

PËRMBAJTJA E BULETINIT

- Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit tetor 2023 dhe 2024
- Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
- Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
- Epidemitë e lajmëruara
- Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
- COVID-19
- Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT TETOR 2023 DHE 2024

Gjatë muajit tetor 2024 janë raportuar **19,013 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(1066.88 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i ultë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2023 (22,531 raste ose Inc 1264.28 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Influenca sezonale (ILI) me 9,608 raste ose 539.13/100,000 banorë**, **Diarea akute me 7,286 raste ose 408.84/100,000 banorë**, dhe **ARI/ITPR me 1,490 raste ose 83.61 në 100,000 banorë (Tab.1)**.

Gjatë muajit tetor 2024 janë raportuar 11 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse., 8 raste me dg. Sepsis me sëmundje përcjellëse, 2 raste me Infiltrat pulmonar me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me dg. Bronchopneumonia me sëmundje përcjellëse

2. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË SIPAS KOMUNAVE, TETOR 2024

Gjatë muajit tetor 2024 në IKShPK, nga grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar, (shih Tabela 1)

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit tetor 2024 në IKShPK janë raportuar 9,608 raste me ILI (Inc. 539.13/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 14.74% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (11,270 raste) por krahasuar me muajin paraprak, shtator 2024 me (10,250 raste të raportuara me ILI) vërehet, rënie prej 6.26%.

Diarea akute: Gjatë muajit tetor 2024 në IKShPK janë raportuar 7,286 raste me Diare akute (Inc.408.84/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (8,639 raste), vërehet një rënie prej 15.66% dhe gjithashtu krahasuar me muajin shtator 2024, me 14,362 raste të raportuara, vërehet rënie prej 49.27%. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë.

ARI/ITPR: Gjatë muajit tetor 2024 në IKShPK janë raportuar 1,490 raste me ARI (Inc.83.61/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,559 raste) vërehet një rënie prej 4.42% %, dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak shtator 2024 me (1,607 raste) të raportuara, rënie prej 7.28%.

Variçella: Gjatë muajit tetor 2024 në IKShPK janë raportuar 386 raste me Variçellë (Inc.21.66/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 me (577 raste) vërehet rënie prej 33.1% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak (216 raste), rritje prej 78.7%.

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë, 01 – 31 tetor të vitit 2023 dhe 2024

Tabela 1.

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë 01 - 31 tetor të vitit 2023 dhe 2024				
Sëmundjet/shkaktarët	Tetor, 2023		Tetor, 2024	
	Nr.	Incidenca / 100,000	Nr.	Incidenca / 100,000
COVID-19	95	5.33	11	0.62
ITPR - Pneumonia/ARI	1559	87.48	1490	83.61
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	5	0.28	21	1.18
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	11270	632.39	9608	539.13
Influenca A		0.00	3	0.17
H.Parainfluenza		0.00	0	0.00
Diarea acute	8639	484.76	7286	408.84
Variçela	577	32.38	386	21.66
Sindromi meningjeal	15	0.84	11	0.62
EHSV		0.00	0	0.00
Helmimet me ushqim	223	12.51	41	2.30
Infeksionet tjera bakteriale me ushqim		0.00		0.00
Rota virus		0.00	14	0.79
Salmonella enteritidis	35	1.96	11	0.62
Shigelloza	1	0.06	0	0.00
Adenovirus		0.00	0	0.00
Enterovirus			0	0.00
Gastroenterokolitet	40	2.24	51	2.86
Hepatiti akut B	6	0.34	3	0.17
Hepatiti akut C		0.00	3	0.17
E.coli patogjene		0.00	0	0.00
Parotiti epidemik	1	0.06	1	0.06
Pertussis		0.00	11	0.62
Tularemia		0.00		0.00
Brucelosis		0.00	6	0.34
Toxoplasmosis	1	0.06	0	0.00
WNV	1	0.06	0	0.00
Sëmundja Lyme	1	0.06	1	0.06
HIV/AIDS	1	0.06	2	0.11
IST	34	1.91	22	1.23
Giardiaza		0.00	1	0.06
Clostridium difficile		0.00	2	0.11
*Sëmundjet tjera ngjitëse	27	1.52	28	1.57
Gjithsej	22531	1264.28	19013	1066.88

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

Grupi i sëmundjeve të raportuara në mënyrë individuale:

Sëmundjet vaksinëpreventabile:

Nga ky grup i sëmundjeve gjatë muajit tetor 2024 janë raportuar 11 raste të dyshimta me Pertussis (raste të dyshimta dhe të konfirmuara) si dhe 1 rast me Parotitis (Tabela 1 dhe 2) . Nga gjithsej 27 raste të testuara si raste të dyshimta me Pertussis, nga laboratorin mikrobiologjik i IKSHPK-së janë konfirmuar 11 raste pozitive, prej të cilëve 6 raste kanë status të rregullt vaksinal. Rastet e konfirmuara sipas komunave: Pejë (4 raste), Prishtina (2), dhe me nga 1 rast komunat: Vushtrri, Lipjan, Deçan, Podujevë dhe Gjilan. Sipas grup-moshës: 0-1 vjeç (3 raste) , 5-9 vjeç (5 raste) dhe 9-18 vjeç (3 raste) , sipas gjinisë 6 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 5 raste i takojnë gjinisë mashkullore.

Zoonozat dhe sëmundjet transmissive:

Nga ky grup i sëmundjeve, gjatë muajit tetor 2024 me Brucellozë janë raportuar 6 raste. Rastet me Brucellozë janë nga zona endemike: Prizren (4 raste), raste nga epidemia familjare, të grup-moshës 60-69 vjeç dhe rasti i një punëtore mishtoreje në si pasojë e kontaktit direkt me kafshë cili i përket grup-moshës 30-39 vjeç. Dy rastet nga Ferizaj janë po ashtu raste familjare, një i gjinisë femërore (30-39 vjeç) dhe tjetri i gjinisë mashkullore (50-59 vjeç).

Gjatë muajit tetor 2024 nga laboratorin i Mikrobiologjisë janë raportuar dy raste pozitive me Leptospirozë. Sipas komunave: 1 rast nga fshati Manastirc i komunës së Ferizajit si dhe 1 rast nga Prishtina. Sipas grup-moshave 30-39 vjeç (1 rast) dhe 60-69 vjeç (1 rast) dhe nga të dy gjinitë me nga 1 rast. Sipas hulumtimit epidemiologjik njëri nga rastet si pasojë e kontaktit direkt si dhe problemeve me brejtës si dhe rasti tjetër mohon kontaktin me kafshët dhe brejtësit

Në muajin tetor është raportuar një rast me Lyme Borreliozë, rast i gjinisë femërore me vendbanim në Prishtinë i përket grup-moshës 20-29 vjeç. Sipas hulumtimit epidemiologjik fundjavat i kalon në Istog, ku kanë kafshë shtëpijake dhe prezencë të rriqërave. Gjithashtu gjatë muajit tetor 2024 është raportuar 1 rast me Echinococcus, i gjinisë mashkullore, nga komuna e Podujevës, i takon grup moshës 80-89 vjeç

ELDSNet – gjatë muajit tetor nga laboratorin i Mikrobiologjisë është raportuar për një rast pozitiv në Legionela Pneumophila nga komuna e Fushë Kosovës, i gjinisë mashkullore, mosha 63 vjeçare me histori të udhëtimit dhe frekuentimit të resorteve në Greqi.

Sindroma meningjeale:

Gjatë muajit tetor 2024 në IKSHPK janë raportuar 11 raste me Sindromë Meningjeale (Inc. 0.62/100 000 banorë). Krahasuar me periudhën e njejtë të vitit paraprak (15 raste), vërehet një rënie prej 26.6%, gjithashtu krahasuar me muajin paraprak shtator 2024 me (17 raste) të raportuara, vërehet rënie prej 35.29%.

Rastet e konfirmuara sipas komunave: Gjakovë (3), Prishtinë (2 raste) kurse me nga 1 rast komunat : Ferizaj, Fushë Kosovë, Klinë, Lipjan, Prizren dhe Malishevë. Sa i përket grup- moshës, rezulton se grup- mosha më e prekur është 0-9 vjeç me (6 raste), 10-19 vjeç me (3 raste), dhe me nga (1 rast) grupmoshat: 40-49 vjeç dhe 60-69, kurse grupmoshat 20-29 vjeç, 30-39 vjeç, 70-79 vjeç dhe mbi 80 vjeç, me asnjë rast të raportuar. Sipas gjinisë, rezulton se 72.7% (8 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore me 27.2% (3 raste). Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, në LCS janë izoluar 2 raste me HHV6 dhe me nga 1 rast me Neisseria meningitidis, Streptococcus pneumoniae, Streptococcus viridans, Enterococcus dhe Mumps virus. Gjatë këtij muaji është raportuar 1 rast i vdekjes me dg. Sepsis Meningococcica filminans, 1 vjeç, i gjinisë mashkullore nga Gjakova.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:

Gjatë muajit tetor 2024 janë raportuar 41 raste me Helmin me ushqim, 51 raste me Gastroenterokolit. Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar: 11 raste me *Salmonella* Enteritidis prej të cilave sipas komunave janë 5 raste Prishtinë, 3 raste Pejë, 2 raste Podujevë dhe 1 rast Vushtrri. Sipas grup moshave 3 raste i takojnë grup moshës 0-9 vjeç, nga 2 raste grup moshave 10-19 vjeç, 20-29 vjeç, 40-49 vjeç dhe nga 1 rast grup moshave 30-39 vjeç dhe 40-49 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 8 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 3 raste gjinisë mashkullore. 14 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 8 raste Prishtinë, 3 raste Gjakovë, 2 raste Fushë Kosovë dhe 1 rast Pejë. Sipas grup moshave 11 raste i takojnë grup moshës 0-4 vjeç dhe 3 raste grup moshës 5-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 8 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 6 raste gjinisë mashkullore, 9 raste me Adenovirus prej të cilave sipas komunave janë: 3 raste Prishtinë, 2 raste Gjakovë, 1 rast Pejë, 1 rast Podujevë, 1 rast Vushtrri dhe 1 rast Dragash. Sipas grup moshave 7 raste i takojnë grup moshës 0-9 vjeç dhe nga 1 rast grup moshave 20-29 vjeç dhe 50-59 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 7 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 2 raste gjinisë mashkullore, 5 raste me Enterovirus (5 raste Prishtinë), sipas grup moshave 4 raste takojnë grup moshës 0-9 vjeç dhe 1 rast grup moshës 10-19 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 2 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 3 raste gjinisë mashkullore, 2 raste me *Clostridium difficile* (2 raste Prishtinë), sipas grup moshave nga 1 rast i takon grup moshës 60-69 vjeç dhe 70-79 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë të dy 2 rastet i takojnë gjinisë femërore.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit tetor 2024, gjithsej 21 raste SARI u raportuan nga mbikëqyrja sentinel. Të gjitha rastet sipas protokollit u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influenza dhe RSV. Të gjithë rastet rezultuan negativ në virusin Influenza dhe RSV.

Rastet SARI sipas komunave janë Prishtinë (14 raste), Fushë Kosovë (3 raste), Prizren (2 raste), Obiliq (1 rast) dhe Drenas (1 rast).

Gjithashtu gjatë muajit tetor 2024, në laboratorin e mikrobiologjisë në IKShPK janë testuar gjithsej 228 mostra të dyshimta në SARS, CoV-2 dhe patogjenët tjerë respiratorë. Nga mostrat e testuara nga Qendrat sentinel janë raportuar gjithsej 6 raste me SARS-CoV2.

Rastet me HIV/AIDS/IST

Gjatë muajit tetor 2024, janë raportuar 2 raste me HIV/AIDS. Rastet i takojnë gjinisë mashkullore, grup moshës 25-34 vjeç dhe janë nga komuna e Prishtinës dhe Fushë Kosovë. Rasti nga komuna e Prishtinës i takon komunitetit MSM, ndërsa rasti nga komuna e Fushë Kosovës rrugën e transmissioinit të infeksioinit e ka heteroseksuale. Sipas informacionit nga Klinika Infektive të dyja rastet janë të spitalizuara dhe janë nën TAR.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht Transmivive (IST), tetor 2024

Gjatë muajit tetor 2024 janë raportuar gjithsej 22 raste me Infeksione Seksualisht Transmivive. Rastet e raportuara janë nga komunat: Prishtinë 8, Pejë 7, Ferizaj 5, Gjakovë 1 dhe Skenderaj 1. Sipas diagnozës: Chlamydia 14 raste dhe Condyloma 8 raste. Sipas gjinisë: 15 rast (68%) i takojnë gjinisë femërore dhe 7 raste (32%) i takojnë gjinisë mashkullore. Grup moshë më e atakuar është 25-49 vjeç, 14 raste (64%), 32% i takojnë grup moshës 15-24 vjeç dhe 1 rast (4%) grup moshës mbi 50 vjeç.

Rastet e HIV infeksioinit:

Laboratori referent në IKShPK për HIV e ka kryer konfirmimin laboratorik dhe raportimi i rezultatit është bërë me anë të postës elektronike, përderisa raportimi nga ana e Kl. Infektive është kryer me anë të Formës raportuese me letër dhe janë sjell në dorë.

Rastet e IST-ve te raportuara nga Klinika e Dermatovenerologjise janë përmes fletave (formave raportuese) dhe janë sjell në dorë në Njësinë për HIV/AIDS/IST, ndërsa rastet nga QRSHP Pejë janë raportua përmes postës elektronike.

Asnjë rast i HIV infeksionit apo IST deri me tani nuk është raportua me SMSN.

Hepatit B dhe C

Gjatë muajit tetor, janë raportuar 3 raste me Hepatit akut B (Mb. 0.16/100.000 banorë). Sipas komunave janë raportuar me nga 1 rast: Prizren, Suharekë dhe Mitrovicë. Sa i përket gjinisë, të tre rastet i takojnë gjinisë mashkullore. Sipas grupmoshës, me nga 1 rast i takojnë grupmoshës 30-39 vjeç, 40-49 vjeç dhe 60-69 vjeç, Gjatë kësaj periudhe, nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me Hepatit B.

Gjatë kësaj periudhe janë raportuar 3 raste me dg. Hepatit akut C (Mb. 0.16/100.000 banorë). Sipas komunave janë raportuar 1 rast në Mitrovicë, 1 rast Prizren dhe 1 rast Suharekë. Sa i përket gjinisë, meshkuj (2 raste) dhe gjinia femërore (1 rast). Sipas grupmoshës, me nga 1 rast i takojnë grupmoshës 20-29 vjeç, 50-59 vjeç dhe 60-69 vjeç. Gjatë kësaj periudhe, nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me Hepatit C.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, tetor 2024

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, tetor 2024																																
SËMUNDJA	Pneumonia/ARI	SARI	ILI	Diarreac	Variçella	Influenca A	Influenca B	COVID-19	Meningjit serosa	Sepsis meningococica	Meningoencephalitis ac.	Parotitis epidemica	Pertussis	Hepatit ac. B	Hepatit ac. C	Helminet me ushqim	Gastroenterokolit	Bruceloz a	Leptospirozoza	Salmoneloz a	E.coli	Rotavirus	Cl.difficile	Borelioz a (Lyme Disease)	Echinokokozë	IST	HIV	Giardiaz a	Infeksionet streptokoksike të gr. A	Sëm. tjera ngjitëse	Totali	
KOMUNA																																
DEÇAN	3		91	101	9			1					1																			206
DRAGASH	29		78	108	4																										1	220
DRENAS	68	1	72	52	5			2									3	1													204	
F. KOSOVË	27	3	359	204	15				1							2	8					2					1				622	
FERIZAJ	27		439	363	8				1								3	2	1								5				849	
GJAKOVË	10		233	182	12			3	1	1	1						2					3				1			3	3	455	
GJILAN	26		414	501	14								1																		956	
GRAÇANICË																															0	
H. I ELEZIT	20		83	31																											134	
ISTOG	11		186	62	2											1									1						263	
JUNIK			31	10																											41	
KAÇANIK			41	55																											96	
KAMENICË	2		278	159	5																										444	
KLINË	35		92	168	14				1																						310	
KLLOKOT																															0	
LEPOSAVIQ																															0	
LIPJAN	8		61	99	19	2			1				1			1	1														193	
MALISHEVË	11		340	274	23				1								1														650	
MAMUSHË																																0
MITROVICË	53		640	429	12			1						1	1	8													1	9	1155	
HTROVICË E VERIUT																																0
N. BËRDË			17	10																												27
OBILIQ	22	1	222	192	23												1	2														463
PARTESH																																0
PEJË	5		869	448	31								4			2					3	1					7			1	1372	
PODUJEVË	29		517	316	9								1			1	9				2				1				1	1	887	
PRISHTINË	951	14	3139	1925	79		1	4	2				2			18	20		1	5		8	2			1	8	1	1	8	6190	
PRIZREN	76	2	693	743	44				1			1		1	1	3	1	4											2		1572	
RAHOVEC	15		47	66	4																									1	133	
RANILLUG																																0
SHTËRPCE																																0
SHTIME	2		91	17																												110
SKËNDERAJ	4		71	72	9											1											1				1	159
SUHAREKË	20		305	318	6									1	1															1		652
VITI	1		155	174																												330
VUSHTRRI	35		44	207	39	1							1				3				1									1	3	335
Z. POTOK																																0
ZVEÇAN																																0
PA ADRESË																																0
TOTALI	1490	21	9608	7286	386	3	1	11	9	1	1	1	11	3	3	41	51	6	2	11	0	14	2	1	1	22	2	1	11	28	19028	

3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRI DHE SPITALET RAJONALE NGA SËMUNDJET NGJITËSE NË KOSOVË GJATË MUAJIT TETOR 2024

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar diaretë akute dhe gastroenterokolitët nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë dhe rastet tjera të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih tabela 3).

Rastet e spitalizuara në Klinikën Infektive, Pediatri dhe spitalet rajonale nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, gjatë muajit tetor 2024

Tabela 3.

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	120
SARI	21
COVID-19	1
Hepatitis B	3
Sindroma meningjeale	11
Helmimet me ushqim	19
Diarea akute dhe gastroenterocolite	172
Status febrilis	10
Salmonelloza	2
Mononucleosis	1
Erysipela	7
Vulnus morsum viperi	2
Total	369



4. EPIDEMITË E LAJMËRUARA GJATË MUAJIT TETOR 2024

Epidemia me Brucellozë, fsh. Prelez i Muhaxherëve-Ferizaj

Pas njoftimit nga zyra regjionale e Inspektoriatit të AUV-it në Ferizaj, për raste me Brucellozë të gjedheve në një fermë në fsh. Prelez i Muhaxherëve, ekipi në QRSHP- Ferizaj, filloi me hulumtimin epidemiologjik. Në familje jetojnë 12 anëtarë dhe kanë biznes familjarë - një fermë me 18 lopë. Vetë anëtarët e familjes kujdesen për mirëmbajtjen dhe mjeljen e kafshëve. Qumshtin kryesisht e dërgojnë në Qumështoren “N.N.” dhe një sasi të vogël e konsumojnë në familje (sipas deklaratave të tyre vetëm për kos). Para 6 muajve ka pasë një abort nga një kafshë, por nuk kanë dyshu në ndonjë sëmundje deri para një muaji kur ka ngordhë një lopë dhe është njoftu AUV-I. Ekipi nga AUV-i më 01.10. 2024 marin 12 mostra prej të cilave 11 mostra me testin ELISA rezultojnë pozitive. Më datë 04.10.2024 janë asgjësuar 11 kafshë dhe është bërë ndalesë e tjetërsimit të kafshëve dhe ndalesë e përdorimit të qumshtit për konsum publik. Janë testuar 8 anëtarë të familjes dhe prej tyre 2 kanë rezultuar pozitiv në Brucellozë: 34 vjeç i gjinisë mashkullore me vendbanim në Fsh. Prelez i Muhaxherëve, Ferizaj, me profesion ushtar i FSK-së, angazhohet edhe me punët në fermë dhe rasti tjetër 55 vjeç e gjinisë femërore me profesion amvise.

Epidemia familjare me Brucellozë në Prizren

Të sëmurë me Brucellozë në këtë epidemi janë 2 raste familjare, një e gjinisë femërore, 61 vjeçar/ASHB pozitiv Wright 1/640 (dt.02.10.2024) dhe rasti tjetër I gjinisë mashkullore, 62 vjeçar/ Rose Bengall-400/positive (dt.04.10.2024). Më datë 10.07.2024 në shtëpi kishin therur një dele me rastin e lindjes së nipit (mohojnë të dinë emrin e pronarit të deleve). Therjen dhe përpunimin e mishit e ka bërë N. M., ndërkaq bashkëshortja i ka ndihmuar rreth përgatitjes. Një javë pas therjes së deles, N. M. I fillon temperatura dhe me dt.19.07.2024 hospitalizohet në Repartin e sëmundjeve Infektive. Gjatë qëndrimit në repart, trajtohet me dg. St. Febrilis. Dy javë më pas sëmuret edhe bashkëshortja (me simptome: temperaturë, ethe, djersitje, dhembje të trupi, humbje oreksi dhe lodhje). Me dt.02.10.2024, rezulton- ASHB pozitiv, Wright 1/640. Pas bashkëshortes më dt.04.10.2024, në laborator privat DIA-Lab në Prizren testohet edhe bashkëshorti i cili rezulton Rose Bengall-400/pozitiv. Raste janë mjekuar në formë ambulantore, me terapinë e ordinuar nga ana e infektologut. Në familje nuk kanë kafshë shtëpiake. Qumështin dhe produktet e qumështit për nevojat familjare i blejnë vetëm në supermarket. Gjendja shëndetësore e pacientëve është në përmirësim.

Epidemia familjare me Hepatit kronik B, fsh. Studençan-Suharekë

Rastet familjare me Hepatit kronik janë raportuar nga reparti infektiv i SP Prizren. Të infektuar janë burrë e grua. Rastet janë raportuar më datë 13.09.2024 rasti i parë dhe rasti i dytë më datë 24.09.2024 52 vjeçare. Me datë 01.10.2024 ekipi për përgjigje epidemiologjike në QRSHP-Prizren, dalin në teren për hulumtim dhe anketim të rasteve dhe marin këto të dhëna: Rasti F.F.B. e gjinisë femërore, 52 vjeçare, asimptomatike (amvise) vuan nga sëmundjet reumatizmale (Osteoarthritis, Spondylozsis lumbalis, Arthritis reactiva). Për shkak të këtyre problemeve është trajtuar në QKUK, Kl. e Reumatologjisë në

Prishtinë, ku testohet në HbsAg para fillimit të trajtimit. Më dt.11.09.2024 në IKSHPK rezulton HbsAg pozitiv. Rasti pohon se para 2 viteve ka mjekuar dhëmbët në një ordinancë private Stomatologjike në Suharekë (nuk i kujtohet emri ordinancës). Mohon intervenime të tjera kirurgjikale. Rasti i dytë F. Xh. B. I gjinisë mashkullore, 54 vjeçar asimptomatik (bujk), në muajin maj, 2023, është operuar nga Hernia Diskale, në QKUK Kl. e Neurokirurgjisë. Nga aspekti epidemiologjik janë ndërmarrë te gjitha masat e nevojshme profilaktike dhe kundër epidemike me qëllim të parandalimit të përhapjes së infeksionit.

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 30 komuna ose 78.9% (30/38) e tyre. Komunat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

6. COVID-19

Gjatë muajit tetor 2024, janë testuar 498 mostra të dyshimta dhe prej tyre kanë rezultuar 11 raste pozitive me SARS-CoV-2 dhe shkallë të pozitivitetit prej 2.2%. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 (95 raste pozitive të raportuara), vërehet një ulje e rasteve të raportuara. Gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes nga COVID-19. (Grafikoni 1).

Sipas komunave, numri më i lartë i rasteve pozitive është nga komuna e Prishtinës dhe Gjakovës me 3 raste të raportuara. Sipas Incidencës: Komunat(Drenas, Deçan dhe Gjakovë me 3/100,000 banorë.


Sipas grup-moshës, numri i rasteve pozitive me COVID-19 janë si vijon: Grup-mosha 40-49 vjeç me 4 raste, 60-69 vjeç me 3 raste si dhe me nga 1 rast grup-moshat:0-9, 50-59, 70-79 dhe 80+ Sipas Incidencës specifike, dominon grup-mosha 65-79 vjeç me 3/100,000 banorë dhe 80+ me 13/100.000 banorë. Sa i përket numrit të rasteve pozitive, sipas gjinisë kemi 5 raste (45%) të gjinisë femërore dhe 6 raste (55%) të gjinisë mashkullore

Në Kosovë varianti i SARS-CoV-2 Omicron BA.2.86 dhe subvariantet e tij, përfshirë KP.3, dominojnë në mesin e mostrave të testuara pozitive në virusin SARS CoV-2, në periudhën një-mujore nga 10 Korrik deri 9 Gusht 2024. Nga variantet kemi: 53% për Variantin KP.3 (44 detektive) dhe 47% për Variantin BA.2.86 (39 detektive).

Rrjedhimisht, prania e nën-linjave të variantit të Omicronit të SARS-CoV-2 në Kosovë është në përputhje të përafërt me epidemiologjinë virologjike të SARS-CoV-2 në vendet tjera Europiane, përkatësisht me dominim të variantit KP.3.

Sipas të dhënave në nivel global, COVID-19 duket se po vendoset në një model të arritjes së pikut dy herë në vit: një në dimër dhe një në verë dhe ndryshe nga gripi, i cili ka një valë në dimër dhe pothuajse asnjë rast më pas, infeksionet e COVID-19 mund të rriten ndërmjet valëve.

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara, të shëruara dhe vdekjet nga COVID-19, tetor 2024



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE BOTË, TETOR 2024

Rasti i konfirmuar Mpox clade Ib në Gjermani

Agjencia gjermane e kontrollit të sëmundjeve, Instituti Robert Koch (RKI), njoftoi të martën se është regjistruar një rast i importuar me Mpox. Pavarësisht zbulimit, zyrtarët e RKI nuk besojnë se tani ekziston një rrezik më i madh për popullatën e gjerë në Gjermani.

Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) është në dijeni të konfirmimit të rastit të parë Mpox clade Ib në Gjermani dhe po monitoron situatën nga afër. Rasti është i importuar dhe i cili u raportua me 18 tetor 2024.

ECDC lansoi më parë një vlerësim të rrezikut për Mpox clade 1 më 16 gusht 2024, duke theksuar gjasat e importimit të mëtejshëm të rasteve Mpox clade I për shkak të lidhjeve të ngushta të udhëtimit midis Evropës dhe Afrikës. Ndërsa rreziku i transmetimit të vazhdueshëm të Mpox në Evropë mbetet i ulët, ECDC këshillon gatishmëri të shtuar, vigjilencë të vazhdueshme dhe zbatim të shpejtë të masave të kontrollit pas zbulimit të rastit.

ECDC, duke punuar ngushtë me partnerët e saj ndërkombëtarë, vazhdon të monitorojë nga afër situatën dhe do të përshtatë rekomandimet e saj sipas nevojës.

Situata epidemiologjike me virusët respiratorë në BE/ZEE

Mbikëqyrja sindromike në kujdesin parësor dhe spitale tregon se aktiviteti i virusëve respirator mbetet në nivelet bazë në shumicën e vendeve të BE/ZEE, të ngjashme me nivelet e vërejtura gjatë sezoneve të mëparshme në këtë periudhë të vitit. Aktiviteti i SARS-CoV-2 në kujdesin parësor dhe spitale vazhdon të ulët në nivel BE/EEA, me raste pozitive më të ulëta ose të ngjashme me ato të vërejtura në 2023. Në këtë periudhë të vitit, situata epidemiologjike mbetet e përzier në nivel vendi, ku shumica e vendeve raportojnë një tendencë në rënie.

Personat e moshës 65 vjeç e lart vazhdojnë të jenë më të prekur nga sëmundja e rëndë COVID-19. Aktiviteti i gripit sezonal mbeti i qëndrueshëm në nivele të ulëta në vendet raportuese të BE/ZEE. Aktiviteti i RSV mbeti i ulët në vendet raportuese të BE-së/ZEE-së dhe në nivele më të ulëta se sa u vëzhguan në krahasim me tre sezonet e fundit. Vendet duhet të përgatiten për të parë një rritje të mundshme të aktivitetit të RSV në javët e ardhshme.

Gripi i shpendëve A(H5N1)

Më 24 tetor 2024, CDC raportoi dy raste humane të gripit të shpendëve A(H5) në SHBA. Të dy personat kishin kontakte me zogjtë e infektuar ose mjediset e tyre në një fermë komerciale vezësh, ku shpendët janë shumë patogjenë. Gripi (HPAI) u zbulua te zogjtë më 15 tetor. Asnjë inga rastet nuk raportoi sëmundje të rëndë ose nuk kërkoi shtrimin në spital. Sipas CDC, nuk ka asnjë provë të transmetimit nga njeriu te njeriu për momentin. CDC në SHBA po kryen analiza gjenetike të viruseve të izoluar nga raste të tjera të konfirmuara. Sekuenca gjenetike konfirmoi se gjashtë nga rastet e raportuara më parë në Kaliforni ishin të infektuar me shpendë virusi i influencës A(H5N1) nga kladi 2.3.4.4b. Të gjashtë sekuenat janë të lidhura ngushtë gjenetikisht me virusin që shkakton infeksione në bagëtinë shtëpiake. U krye sekuenca e të gjithë gjenomit viruset e izoluar nga dy persona në Kaliforni dhe të dy viruset u konfirmuan se ishin B3.13 gjenotip.

CDC në SHBA po kryen testime shtesë, duke përfshirë karakterizimin antigjenik të viruseve të izoluar. Kjo do të zbulojë nëse viruset ekzistuese të vaksinës kandidate (CVV) përputhen mirë me raportet e reja për rastet e gripit të shpendëve A(H5). CDC ka postuar në GISAID dhe ka dorëzuar në GenBank hemagglutininën (HA), neuraminidazën (NA) dhe segmentet gjenike jo-strukturore (NS) për A/California/134/2024 (GISAID)

EPI_ISL_19463619; NCBI_PQ435213- PQ435215) dhe të gjithë sekuencat e gjenomit për A/California/135/2024 dhe A/California/147/2024. Më 24 tetor CDC publikoi gjithashtu rezultatet e një hetimi retrospektiv të rasteve që kishin pasur kontakt të ngushtë me rastin e H5N1 të raportuar në Misuri në shtator 2024. Shtatë persona, përfshirë pesë punonjës të kujdesit shëndetësor, pacientin e raportuar dhe një anëtarë të familjes së pacientit janë identifikuar për analiza të mëtejshme serologjike. CDC mbështeti këtë hetim duke testuar mostrat e gjakut nga gjashtë prej këtyre kontakteve.

Asnjë nga punonjësit e kujdesit shëndetësor nuk tregoi shenja të H5N1 të kaluar, duke përjashtuar transmetimin nga njeriu te njeriu ndërmjet individit dhe punonjësve të kujdesit shëndetësor.

Rasti nga Misuri dhe një kontakt familjar kishin disa shenja jokonsistente që sugjeronin të ishte e mundur

ekspozimi ndaj, ose një infeksion të mëparshëm me, H5N1. Nga fillimi i vitit 2024 deri më 24 tetor 2024, janë raportuar gjithsej 31 raste humane të influencës së shpendëve A(H5) në SHBA. Nga këto raste, 19 ishin individë të ekspozuar ndaj bagëtime qumështore që ishin të infektuara, ose supozohet se ishin të infektuar, me A(H5N1) dhe 11 ishin punëtorë të ekspozuar ndaj shpërthimeve të HPAI A(H5) në fermat komerciale të vezëve. Një person nuk kishte asnjë ekspozim të njohur të kafshëve. Vlerësimi aktual i CDC-së për rrezikun e shëndetit të njeriut të A(H5N1) për publikun e gjerë në SHBA nuk ka ndryshuar dhe vazhdon të konsiderohet i ulët.

8. REKOMANDIMET

Në funksion të pasqyrës reale të situatës epidemiologjike në Kosovë, sëmundjet ngjitëse duhet të raportohen nga të gjitha komunat e Kosovës në kohë reale, në mënyrë që informata kthyesë dhe përgjigja epidemiologjike të jetë me kohë.

Sëmundjet zoonotike dhe ato që përcillen nga vektorët po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe po ndryshojnë pasqyrën e ngarkesës nga sëmundjet ngjitëse, prandaj rekomandojmë themelimin e komitetit për shëndetin human, animal dhe mjedisor “Një shëndet”.

Inspektorët shëndetësor dhe sanitar të bëjnë mbikëqyrjen e sistemit të raportimit të sëmundjeve ngjitëse, bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200 për mënyrën e regjistrimit dhe paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse si në Institucionet shëndetësore publike dhe private.

INSITUTI KOMËTAR I SHËNDETËSISË**PUBLIKE TË KOSOVËS****Departamenti i Epidemiologjisë****Adresa: Rr. Nëna Terezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë 10000****WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>****E-mail: ariana.kalaveshi@rks-gov.net****Telefoni+38338 551432, ext. 1013**

